



Temat e Takimit:	1. Prezantimi i shkurtër i secilit pjesëmarrës 2. Raportim nga Dom Ambroz Demaj 3. Diskutim për formimin e komisionit mbikëqyrës 4. Mbledhja e donacioneve dhe organizimi i hapave të ardhshëm 5. Prezantimi i faqes së internetit të projektit 6. Diskutim i hapur me pjesëmarrësit
Data:	15.12.2024
Ora:	18:30 – 20:30
Vendndodhja:	Online – Zoom-Meeting
Pjesëmarrësit:	Dom Ambroz Demaj, Gentian Berisha, Gjokë Martini, Kolë Berisha, Laura Berisha, Marjan Gojani, Petrit Gojani, Zef Shala, Zog Berisha
Kryesuesi:	Kolë Berisha
Dokumentator:	Kolë Berisha

Përmbledhje e Takimit

Në fillim të takimit, disa pjesëmarrës hasën në vështirësi teknike, pasi për shkak të shtyrjes së takimit, disa u përpoqën të kyçeshin me të dhënat e vjetra. Kjo situatë shkaktoi vonesa derisa u sqarua që ishte dërguar një ftesë e dytë për datën e re të takimit.

Gjatë kohës që pritnim pjesëmarrësit tjerë, me ata që ishin kyçur në kohë u diskutuan pika të ndryshme lidhur me projektin. Me ardhjen graduale të pjesëmarrësve të tjerë, takimi mori një rrjedhë të natyrshme, ku nuk u ndoq rendi i caktuar i pikave, përveç pikës së fundit:

Diskutim i hapur me pjesëmarrësit.

Në këtë diskutim të hapur u shprehën mendime dhe pikëpamje të ndryshme për projektin, duke përfshirë qëndrime thellësisht pesimiste, kritike dhe të pashpresa, si dhe mendime optimiste dhe realiste, sipas pikëpamjeve të pjesëmarrësve, të cilat shpesh shoqëroheshin me përballje të ashpra verbale.

Dom Ambroz Demaj, me optimizmin dhe qëndrimin e tij të fuqishëm gjatë këtij takimi, u përpoq të përçonte shpresë dhe besim se ky projekt për ndërtimin e kishës së **Shen Nënë Terezës** në fshatin tonë, Dugajeve, do të fillojë në pjesën e hershme të vitit 2025. Angazhimi



dhe optimizmi i tij arritën të motivojnë dhe frymëzojnë disa pjesëmarrës për të vazhduar përpjekjet.

Përfundimi i Takimit

Pas një diskutimi të hapur, të ndershëm dhe intensiv, i cili nxiti reflektime të ndryshme mbi projektin, takimi përfundoi pa konkluzione konkrete. Në fund, pjesëmarrësit e uruan njëri-tjetrin për festat e fundvitit.

Kolë Berisha falënderoi Don Ambroz Demajn për optimizmin dhe mbështetjen e tij ndaj projektit.

¹ Në mënyrë ironike, njëri prej pjesëmarrësve iu drejtua Kolë Berishës me fjalët: „Kolë, trego një shaka dhe të shkojmë me ra në gjumë, se nga ky projekt s’do të ketë asgjë; ky projekt ka dështuar.“